



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM
Nr 38 Datë 06.05.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E K.B. Nr. 25. datë 14.04.2010.
“PËRCAKTIMIN E INVESTIMEVE PËR GRANTET KONKURUESE PËR VITIN 2010”**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi morri në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban e Hartimit të Projekteve në Infrastrukturë dhe Drejtoria e Financës, "Për disa ndryshime në Vendimin e K.B. Nr. 25. datë 14.04.2010 "Për caktimin e prioriteteve të investimeve për grantet konkuruese për vitin 2010", mbështetur në :Ligji nr. 8652 dt.31.07.2000 " Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes vendore "neni 32 pika dh ,ligji 10190 dt.26.11.2009 " Për buxhetin e vitit 2010",Udhëzimin Nr.1 datë 21.01.2010 " Për zbatimin e Buxhetit për Vitin 2010", ligji nr. 9936 dt.26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë "dhe ligji nr. 8399 dt.09.09.1998 " Për buxhetin lokal ", në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve, si dhe pas kërkesave të Drejtorisë Arsimore dhe F.SH.F-së

VENDOSI :

- I. Të miratojë ndryshimin në prioritetet e investimeve për Grandet Konkuruese për vitin 2010, si vijon :

Për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës:

1. Rikonstruksioni dhe termoizolim i godinës së shkollës së mesme të përgjithshme "Raqi Qirinxhi" me fondin prej **45.000.000** lekë, në vend të ndërtim shkollë e re e mesme me fondin prej **100.000.000** lek.

Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sporteve::

1. Ndriçimi i stadiumit "Skënderbeu", me fondin prej **10.000.000** lek, të ndryshohet me fondin prej **27.166.000** lek pasi kjo është vlere në lekë e kontributi të kërkuar nga Bashkia Korçë ose ndryshe 49% e vlerës totale prej **55.440.000** lekë të investimit. Kjo vlerë është përcaktuar sipas projektit dhe preventivit të hartuar nga specialistë të Federatës Shqiptare të Futbollit sipas standarteve të FIFA-s.

- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Projekteve në Infrastrukturë, Drejtoria e Financës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

GJERGJI PENDAVINJI